

## SKANIMI I KONTRATAVE TË HEC-eve

Aktualisht kanë kaluar procesin e skanimit 54 dosje, 8 prej të cilave kanë rezultuar me probleme të mëdha dhe shkelje të kushteve kontraktuale, për të cilat do të fillohet procedura për ndërprerjen në mënyrë të njëanshme të kontratës. Problematikat e konstatuara do të shërbejnë si referencë për ndryshimet ligjore që do të propozohen në këtë sektor.

## INVESTIM 130 MILIONË LEKË I OSHEE

Një investim me vlerë 130 milionë lekë i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, për rikonstruksionin e rrjetit të tensionit të ulët përgjatë segmentit rrugor Elbasan-Cërrik, do të ofrojë një cilësi më të mirë të furnizimit me energji elektrike për afro 9 mijë banorë të kësaj zone si dhe do ketë impakt në zhvillimin e sektorit bujqësor dhe zhvillimin e turizmit.

## KONTROLLI I GURORREVE KRASTË- VERJON

Subjektet që ushtrojnë aktivitet minerar në zonën e shpallur pejsazh i mbrojtur natyror Krastë-Verjon, nuk kanë zbatuar projektin teknik të hapjes dhe shfrytëzimit të objekteve minerare duke krijuar probleme të sigurisë teknike dhe mbrojtjes së mjedisit. Në përfundim të kontrollit të ushtruar nga Task Forca e MIE për të 12 subjektet që ushtrojnë aktivitet në këtë zonë është marrë vendimi për fillimin e procedurës së revokimit të lejes minerare.

## NDËRHYRJE PËR SIGURINË RRUGORE

Në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Rrugore, ARRSH, me mbështetjen e Bankës Botërore, ka nisur punën për eliminuar një nga pikat e rrezikshme të aksit të Qafë Thanës. Investimi në fjalë parashikon ndërhyrjen për mbrojtjen dhe përforcimin e skarpatës me mure mbajtëse, të lartësisë nga 3 deri në 5 metra, për një gjatësi gati 82 metra linear

## NDRYSHIMI I PRONËSISË SË MJETEVE

Ndryshimi i pronësisë së mjeteve tashmë ofrohet edhe në sportelet e 13 Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Tarifa e re prej vetëm 1400 lekë përfshin, verifikimin online Interpol, verifikimin e mjetit online në sistem për taksa/detyrime/bllokime, administrim të kontratës tip dhe dosjes.

## ZYRË E RE SHËRBIMESH

Çelet zyra e re e shërbimeve të Transportit Rrugor në Çorovodë. Tashmë qytetarët mund të marrin shërbime më afër vendbanimit të tyre për 8 procedura, duke krijuar kështu një lehtësim për 1832 zotërues mjetesh.